



Në bazë të nenit 7, alineja 9 të Ligjit për themelimit të Agjencisë për përkrahje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural ("Gazeta Zyrtare" e Republikës së Maqedonisë nr. 72/07 dhe 5/09), Agjencia për përkrahje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural shpall

**THIRRJE PUBLIK nr. 02/2011**  
**për dorëzimin e kërkesave për shfrytëzim të mjeteve nga Programi për përkrahje financiare të zhvillimit rural për vitin 2011**

**I. LËNDA E SHPALLJES**

Lëndë e kësaj shpalljeje është ndarja e përkrahjes financiare për masat në vijim:

<b>Grupi i masave 1</b>	<b>Rritje të konkurrencës të prodhimit të bujqësore</b>	<b>Vlera maksimale e shpenzimeve të pranueshme (deri)</b>
Masa 1.4	<p>Lidhje ekonomike të ekonomive bujqësore për kryerje të përbashkët të veprimtarisë bujqësore</p> <p>Mjetet janë të parapara për:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- ndihmë për vendosje të kooperativës me veprimtari kryesore nga fusha e bujqësisë dhe e themeluar nga bartës të ekonomive bujqësore të regjistruar në Regjistrin e vetëm të ekonomive bujqësore pranë MBPEU; dhe</li> <li>- ndihmë për organizim të aktiviteteve informative dhe promovuese për prodhime bujqësore të prodhuara dhe plasuar nga kooperativa bujqësore.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- deri më 3.000.000 denarë për vendosje të kooperativës dhe mirëmbajtje të punës të tash më kooperativave të vendosura; dhe</li> <li>- deri më 1.700.000 denarë për ndihmë për organizim të aktiviteteve informative dhe promovuese për prodhime bujqësore të prodhuara dhe plasuar nga kooperativa bujqësore.</li> </ul>
Shpenzime të pranueshme për vendosje të kooperativës dhe mirëmbajtje të punës të tash më kooperativave të vendosura	<ul style="list-style-type: none"> <li>- shpenzime për vendosje të kooperativës bujqësore përveç kooperativave tash më ekzistuese bujqësore;</li> <li>- shpenzime për marrje me qira të hapësirave dhe objekteve për punë të kooperativës përveç të tash më kooperativave ekzistuese;</li> <li>- shpenzime për furnizim të pajisjes kompjuterike, mobileve për zyrë dhe softuer kompjuterik për planifikim, menaxhim, përcjellje dhe kontrollim përveç të tash më kooperativave ekzistuese;</li> <li>- bruto rrogë të personave profesional për menaxhim me kooperativën bujqësore, punëtorëve administrativ dhe teknik;</li> <li>- shërbime nga persona të tretë për udhëheqje të kontabilitetit dhe revizion të punës së kooperativës bujqësore;</li> <li>- shërbime nga persona të tretë për edukim të personave të punësuar profesional në kooperativën bujqësore;</li> <li>- shërbime nga persona të tretë për organizim dhe realizim të programeve për trajnim të anëtarëve të kooperativës bujqësore duke përfshirë edhe harxhimet e rrugës dhe ditore të anëtarëve të kooperativës bujqësore me shumë e cila nuk kalon 800 denarë në ditë për anëtar; dhe</li> <li>- shpenzime për organizim të ngjarjeve promovuese për tërheqje dhe zgjerim të anëtarësisë të kooperativës</li> </ul>	<p>Shuma e shpenzimeve të pranueshme për kooperativa të themeluara në periudhën prej 01.01.2007 deri më 31.12.2009 në shumë prej:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- 20% për kooperativat bujqësore të themeluara në vitin 2007;</li> <li>- 40% për kooperativat bujqësore të themeluara në vitin 2008,</li> <li>- 60% për kooperativat bujqësore të themeluara në vitin 2009;</li> <li>- 80% për kooperativat bujqësore të themeluara në vitin 2010 dhe 2011; dhe</li> <li>- 100% për shpenzime të pranueshme me qëllim për organizim të programeve për trajnim dhe harxhime për rrugë dhe ditore të anëtarëve të kooperativës bujqësore;</li> </ul>
Shpenzime të pranueshme për ndihmë për	<ul style="list-style-type: none"> <li>- shpenzime për organizim të ngjarjeve promovuese për promovim të kooperativës bujqësore dhe prodhimeve të saj;</li> <li>- pjesëmarrje në manifestimet e panairëve;</li> </ul>	<p>Shuma e shpenzimeve të pranueshme në shumë prej 100% nga harxhimet e përgjithshme të</p>



organizim të aktiviteteve informative dhe promovuese për prodhime bujqësore të prodhuara dhe plasuara nga kooperativa bujqësore	<ul style="list-style-type: none"> <li>- shërbime nga persona të tretë për përpilim të planit për komunikim dhe promovim të kooperativës bujqësore;</li> <li>- shërbime nga persona të tretë për përpilim, printim dhe distribuim të katalogjeve dhe materialit propagandues;</li> <li>- shërbime nga persona të tretë për përpilim dhe printim të materialit informativ për kooperativën dhe dizajn të shenjave identifikuese të kooperativës; dhe</li> <li>- shërbime nga persona të tretë për rregullim dhe mirëmbajtje të ueb-faqes të kooperativës bujqësore;</li> </ul>	pranueshme për realizimin e aktiviteteve të parapara në programin për punë të kooperativës bujqësore ose dokumente të tjera planifikuese të miratuara nga kuvendi dhe në pajtim me statutin
---	---	---

<b>Grupi i masave 2</b>	<b>Masa për avancim të mjedisit jetësor dhe pjesëve rurale</b>	<b>Vlera maksimale e shpenzimeve të pranueshme (deri)</b>
Masa 2.1	Ndihmë për mbrojtje të mjedisve rurale dhe karakteristikat e tyre tradicionale	Jo më shumë se 300.000 denarë për person të punësuar
	Mjetet janë të parapara për kompensim të harxhimeve për ruajtje nomade të deleve dhe blegtori tradicionale në lartësi prej 80% të bruto pagës mesatare në veprimtari për periudhën prej 01.11.2010 deri më 30.10.2011 për bari të punësuar me proporcion 1 bari për 150 dele	1.500.000 denarë
Kriteret	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Minimum 150 dele nga të gjitha kategoritë</li> <li>- Mbështetja ndahet në proporcion – 1 bari i punësuar për 150 dele</li> </ul>	
		Numri i personave të punësuar për të cilët është paguar mbështetja duhet të jetë i njëjtë së paku një vit nga viti për të cilin është e miratuar dhe paguar përkrahja

## II. E DREJTA PËR SHFRYTËZIMIN E MJETEVE

Të drejtë për shfrytëzimin e mjeteve kanë subjektet në vijim, edhe atë për masat:

<b>Subjektet</b>	<b>Masat</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Kooperativë ose person juridik me veprimtari kryesore nga fusha e bujqësisë dhe e themeluar nga bartësit e ekonomive bujqësore të regjistruara në RVEB;</li> <li>- Kooperativë ose person juridik me veprimtari kryesore nga fusha e bujqësisë dhe e themeluar nga bartës të ekonomive bujqësore të regjistruar në RVEB dhe kapaciteteve përpunuese për përpunim të prodhimeve bujqësore-ushqimore; dhe</li> <li>- Person juridik nga fusha e bujqësisë të formuar nga shoqata e prodhimeve bujqësore;</li> </ul>	1.4
Ekonomi bujqësore të regjistruara në Regjistrin e vetëm të ekonomive bujqësore në pajtim me Ligjin për ekonomi dhe zhvillim rural pranë Ministrisë së bujqësisë, pylltarisë dhe ekonomisë së ujërave	2.1

## III. KUSHTET PËR SHFRYTËZIM TË MJETEVE DHE DOKUMENTACIONI QË DUHET TË DORËZOHET

Kërkesat për masë veç e veç dorëzohen në kopje origjinale.

Kushtet të cilat kërkuesit e mjeteve duhet t'i plotësojnë janë të përcaktuara me Programin për përkrahje financiare të zhvillimit rural për vitin 2011 (Gazeta Zyrtare nr. 23/2011, 72/2011, 141/2011), Ligjin për bujqësi dhe zhvillim rural (Gazeta Zyrtare nr. 49/2010, 53/2011) dhe Rregulloren për kushte plotësuese, shpenzime të pranueshme, dhe lartësi të përkrahjes për shpenzimet e pranueshme për shfrytëzues për masë veç e veç nga programi për përkrahje financiare të zhvillimit rural (Gazeta Zyrtare nr. 124/2011).



Nëse deri tek Agjencia dorëzohen më shumë kërkesa se sa ka mjete në dispozicion në pajtim me **Programin për përkrahje financiare të zhvillimit rural për vitin 2011**, Agjencia do t'u jep përparësi atyre kërkesave të cilët kanë dorëzuar kërkesën e tyre më herët se të tjerët.

Një kërkesë mund të dorëzojë një kërkesë vetëm për një masë. Një kërkesë mund të dorëzojë më së shumti 2 kërkesa veç e veç për masa të ndryshme duke i marrë parasysh edhe masat e tjera nga Programi për zhvillim rural për vitin 2011 të publikuar në thirrjen e kaluar.

#### **IV. MARRJA E FORMULAREVE DHE UDHËZIMEVE**

Formularët “Kërkesa për pagesë” së bashku me listën për dokumentet e duhura mund të merret në ueb faqen e Agjencisë [www.ipardpa.gov.mk](http://www.ipardpa.gov.mk).

Formularët e lartpërmendur mund të merren edhe drejtpërdrejtë në Agjenci në adresë çdo ditë pune prej ora 8:30 deri në ora 16:30:

**Agjencia për përkrahje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural,  
Rr. 3-ta Makedonska Brigada pn, Ndërtesa e Makedonia Tabak Blloku C  
1000 Shkup**

#### **V. НАЧИН НА ДОСТАВУВАЊЕ НА ДОКУМЕНТИТЕ**

Kërkesat e plotësuara për pagesë nga Programi për përkrahje financiare të zhvillimit rural për vitin 2011 në gjuhën maqedonase së bashku me tërë dokumentacionin e duhur dorëzohen në zarf të mbyllur me shënim në këndin e majtë lart të anës së përparme të zarfit “MOS HAP” për Thirrjen publike nr. 02/2011 dhe shënimin e numrit të masës për të cilën dorëzohet kërkesa. Kërkesa mund të dorëzohet përmes postës ose personalisht në arkivin e Agjencisë, në të kundërtën Agjencia nuk merr përgjegjësi për humbjen apo hapjen e parakohshme të kërkesës

**Afati i fundit për dorëzimin e kërkesave është 25.11.2011. Kërkesat e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk do të merren në shqyrtim**

Informata më të hollësishme në kontakt tel. (02) 3097-460 ose në kontakt e-mail adresën: [ipardpa.info@ipardpa.gov.mk](mailto:ipardpa.info@ipardpa.gov.mk) dhe në ueb-faqen: [www.ipardpa.gov.mk](http://www.ipardpa.gov.mk)

Kontakt:

Agjencia për përkrahje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural, Sektori për aprovim të pagesës.  
Telefoni **02 3097460**, çdo ditë pune prej ora 10.00 deri në ora 14.30

E-mail: [ipardpa.info@ipardpa.gov.mk](mailto:ipardpa.info@ipardpa.gov.mk)